



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Mbledhja plenare e Kuvendit
P- 34
Prishtinë, më 14 tetor 2011

P R O C E S V E R B A L

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 14 TETOR 2011**

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar Kuvendit, kurse i ndihmoi **Xhavit HALITI**, nënkryetar i Kuvendit.

Kryetari deklaroi të hapur punimet e mbledhjes plenare dhe i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me përfaqësuesit e grupeve parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për mbledhjen e sotme plenare.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

R e n d i t e

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes plenare të mëparshme,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndihmë juridike falas,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-001 për përfitimin e ish-zyrtarëve të lartë,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për akcizën në produktet e duhanit,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Agjencinë Kosovare të Forenzikës,
8. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarit në Bordin e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën deputetët: Ramiz Lladrovci, Hykmete Bajrami, Albin Kurti, Ardian Gjini, Muhamet Mustafa, Emilija Rexhepi, Justina Shiroka-Pula, Ismet Beqiri, Sabri Hamiti, kryeministri Hashim Thaçi dhe zv. kryeministri Hajredin Kuçi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputetja Nazane Breca, parashtroi pyetje për ministrin Ferid Agani, në lidhje me draftimin e Projektligjit të kujdesit parësor shëndetësor.

Ministri Agani iu përgjigj pyetjes së deputetes Nazane Breca.

Deputetja Nazane Breca, parashtroi pyetje për ministrin Ferid Agani, në lidhje me fuqizimin dhe aprovimin e urdhrit të mjekut dhe infermieres.

Ministri Agani iu përgjigj pyetjes së deputetes Nazane Breca.

Deputetja Alma Lama, parashtroi pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi, në lidhje me mos emërimin e zëdhënësit të Qeverisë së Kosovës.

Me autorizim të kryeministrit, pyetjes së deputetes Alma Lama, iu përgjigj zëvendëskryeministri, Hajredin Kuçi.

Deputeti Armend Zemaj, parashtroi pyetje për ministrin Ferid Agani, në lidhje me masat e ndërmarra pas vjedhjes së kompjuterit me të dhënat mbi regjistrimin e barnave në Agjencinë Kosovare për Produkte Medicinale.

Ministri Agani iu përgjigj pyetjes së deputetit Armend Zemaj.

Deputeti Xhevdet Neziraj, parashtroi pyetje për ministrin Radojica Tomiq, në lidhje me zbatimin e programit për kthim, në komunat: Pejë, Istog etj.

Ministri Radojica Tomiq, nuk ishte i pranishëm në mbledhje.

Deputetja Hykmete Bajrami, parashtroi pyetje për ministrin Fehmi Mujota, në lidhje me hetimet që çuan në mbylljen e Qendrës së patentë shoferëve Prishtinë.

Ministri Mujota iu përgjigj pyetjes së deputetes Hykmete Bajrami.

Deputetja Time Kadrijaj, parashtroi pyetje për ministrin Ferid Agani, në lidhje me përzgjedhjen e duhur, apo jo, për drejtor të QKUK-së dhe Kryeinspektorit shëndetësor.

Ministri Agani, iu përgjigj pyetjes së deputetes Time Kadrijaj.

Deputeti Afrim Kasolli, parashtroi pyetje për ministrin Ramë Buja, në lidhje me vendimin për fondin për shkencë, të marrë nga Ministria e Arsimit, në mandatin e kaluar.

Ministri Buja, iu përgjigj pyetjes së deputetit Afrim Kasolli.

Deputeti Imri Ahmeti, parashtroi pyetje për ministrin Mahir Yagcilar, në lidhje me afatin kohor të nisjes së zbatimit të Ligjit mbi pagat e shërbyesve civil.

Ministri Yagcilar, iu përgjigj pyetjes së deputetit Imri Ahmeti.

3. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes plenare, të mbajtur me 6 tetor 2011

Kuvendi, miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes plenare, të datës 6 tetor 2011.

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndihmë juridike falas

Kryesuesi, Xhavit Haliti, i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit funksional raportues për Projektligjin për ndihmë juridike falas.

Raportin e Komisionit funksional për Legjislacion, e arsyetoi kryetari i këtij komisioni, deputeti Arben Gashi.

Në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, foli deputeti Naser Osmani, i cili propozoi që ky Projektligj të shtyhet në njërën nga mbledhjet plenare të ardhshme.

Në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, zëvendëskryeministri Hajredin Kuçi tha se përkrah propozimin e deputetit Naser Osmani.

Me propozimin e z. Naser Osmani u pajtua edhe kryetari i Komisionit për Legjislacion, z. Arben Gashi.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim propozimin për shtyrjen e shqyrtimit të dytë të Projektligjit për ndihmë juridike falas.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë

V E N D I M

1. Kuvendi vendosi që Projektligji për ndihmë juridike falas të shtyhet për shqyrtim të dytë edhe për pesëmbëdhjetë (15) ditë.
2. Kuvendi ngarkoi: Komisionin funksional për Legjislacion dhe Komisionin për Buxhet dhe Financa, që të rishikojnë edhe një herë vlerësimin e ndikimit buxhetor të këtij Projektligji, në bashkëpunim me Ministrin e Financave, dhe Kuvendit t'i paraqesin Raportin me rekomandime, për shqyrtim në mbledhje plenare.

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-001 për përfitimin e ish-zyrtarëve të lartë

Kryesuesi i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit funksional raportues për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-001 për përfitimin e ish-zyrtarëve të lartë.

Raportin e Komisionit funksional për Legjislacion e arsyetoi kryetari i këtij komisioni, deputeti Arben Gashi.

Ai tha se Komisioni që ai drejton ka rekomanduar miratimin e këtij Projektligji, sipas propozimit të Qeverisë, dhe nuk ka arsye për amendamentimin e neneve të këtij Projektligji.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës diskutoi edhe deputetja Albulena Haxhiu, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-001 për përfitimin e ish-zyrtarëve të lartë, sipas propozimit të Qeverisë.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 45,
Kundër----- 1,
Abstenime----- 11.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-001 për përfitimin e ish-zyrtarëve të lartë.

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për akcizën në produktet e duhanit

Kryesuesi i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit funksional raportues për Projektligjin për akcizën në produktet e duhanit.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Visar Ymeri, Salihe Mustafa dhe Naser Osmani, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Në vazhdim, kryesuesi hodhi në votim amendamentet veç e veç.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, dhe amendamentin nr. 13.

Kuvendi nuk miratoi amendamentin nr. 5.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 61,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 3.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi Ligjin për akcizën në produktet e duhanit.

7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Agjencinë Kosovare të Forenzikës

Kryesuesi i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit funksional raportues për Projektligjin për Agjencinë Kosovare të Forenzikës.

Raportin e Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, e arsyetoi anëtari i këtij komisioni, deputeti Fatmir Xhelili.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës diskutoi edhe deputeti Sali Morina, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Në vazhdim, kryesuesi hodhi në votim, një nga një, amendamentet e propozuara.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, dhe amendamentin nr. 9.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----	56,
Kundër-----	0,
Abstenime-----	6.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi Ligjin për Agjencinë Kosovare të Forenzikës.

8. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarit në Bordin e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale

Kryesuesi i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri lidhur me Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarit në Bordin e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale.

Pastaj, kryetari hapi debatin për shqyrtimin e Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarit në Bordin e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë pikë të rendit të ditës dhanë deputetët: Donika Kadaj-Bujupi, Sabri Hamiti, Sala Berisha-Shala, Ardian Gjini, Burim Ramadani, Florin Krasniqi, Shaip Muja, Jakup Krasniqi, Zenun Pajaziti dhe zv.kryeministri Hajredin Kuçi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve Grupi Parlamentar i LDK-së, Grupi Parlamentar i AAK-së dhe Grupi Parlamentar i lëvizjes “Vetëvendosje” e lëshuan sallën me arsyetim se të propozuarit nga ana e Qeverisë, për anëtar në Bordin e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, nuk janë kandidatë profesionalisht më të mirë.

Në mungesë të kuorumit, kryetari e deklaroi të mbyllur seancën plenare në orën 12:50 minuta..

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Përgatiti: Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale.